



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 07
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 11 dhjetor 2017, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Haxhi Avdyli, Flora Brovina, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Faton Topalli, Naser Rugova dhe Bekim Haxhiu.

Pjesëmarrës të tjerë: Nora Sahatçiu, UNDP; Ervin Ibrahim, UNDP; Dren Rexha, UNICEF; Gramoz Paqarada, KDI dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit, lidhur me të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues në Kosovë;
3. Diskutim i Draft-Rezolutës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit, lidhur me të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues në Kosovë

Kryetarja – Ky raport është përgatitur në vitin 2016, mirëpo për shkak se Kuvendi është shpërndarë, nuk është shqyrtuar nga komisioni, dhe në këtë rast, Avokati i Popullit e ka riproceduar përsëri për shqyrtim nga ana e komisionit. Ky raport ka për qëllim vlerësimin në nivel vendi, lidhur me të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues, si dhe shkallën e respektimit të këtyre të drejtave, të garantuara me Kushtetutë. Pra, si institucione, kemi obligim t'i përgjigjemi Avokatit të Popullit. Në këtë raport, janë dhënë disa rekomandime, që kërkohet që të adresohen, dhe një numër i madh i rekomandimeve, si deputetë, por edhe si komision, veç i kemi adresuar. Lidhur me çështjen e rritjes së buxhetit për shëndetësi, kemi miratuar Rezolutën për Sistemin Informativ Shëndetësor (SISH), kemi kërkuar që lista e barnave esenciale të mbulohet në vazhdimësi. Po ashtu, shumë rekomandime tjera janë adresuar, sepse edhe rekomandimet tjera ne kemi obligim, si deputetë edhe si komision, t'i adresojmë apo të kërkojmë nga organet kompetente që t'i adresojmë këto rekomandime, që kanë dalë nga ky raport. Sa i përket rekomandimit të abortit të moshat 16 vjeçare, ne e kemi Ligjin për abortin dhe po besoj se është i qartë dhe duhet trajtuar këtë çështje me kujdes.

Time Kadrijaj – Ne e kemi shqyrtuar raportin. Në fakt, ky raport nuk i adresohet vetëm komisionit apo Ministrisë së Shëndetësisë, mirëpo ju adresohet pothuajse të gjitha institucioneve. Unë mendoj se shumica e rekomandimeve janë me vend dhe janë çështje mjaft të rëndësishme, të cilat duhet adresuar në të ardhmen, pra se cilat rekomandime janë adresuar dhe cilat kanë nevojë të adresohen nga ana e institucioneve. Për adresim të disa rekomandimeve, përgjegjës është Inspektorati Shëndetësor, mirëpo të gjithë e dimë se ky institucion nuk është mbështetur apo fuqizuar, për të përmbushur obligimin ligjor që e ka. Pra, inspektorati është i vetmi mekanizëm mbikëqyrës i institucioneve shëndetësore. Me një numër shumë të vogël të inspektorëve, është e pamundur që të kemi një efikasitet nga ana e tyre, sa i përket cilësisë së shërbimeve shëndetësore, nga secili institucion. Ne duhet t'i adresojmë këto rekomandime, që i përkasin komisionit tonë dhe të kërkojmë nga institucionet adresimin tyre. Secili komision, në bazë të përgjegjësisë, t'i adresojë rekomandimet që janë në fushëveprim të tyre.

Fatmire Kollçaku-Mulhaxha – Sot po shqyrtojmë një temë të një rëndësie të veçantë për disa kategori, të cilat kanë nevojë për mbështetje. Po shqyrtojmë raportin e Avokatit të Popullit për disa çështje që besoj se edhe ne duhet t'u japim mbështetje dhe t'i adresojmë këto rekomandime. Te shërbimet e preventives, duhet të fokusohemi shumë në parandalim, pasi që më lehet është të parandalohet se sa të trajtohet. Ne kemi një bazë të mirë ligjore, mirëpo duhet të mbështeten edhe me buxhet, që të implementohen. Te çështja e abortit, duke përfshirë moshat e reja, si dhe vikamat e dhunës në familje, duhet mbështetje institucionale e tyre. Sa i përket shëndetit riprodhues, ne kemi legjislacionin, mirëpo kemi ngecje në zbatim të tij. Këto rekomandime i adresohen Qeverisë dhe detyra e jonë, si komision, të monitorojë punën e Qeverisë dhe zbatimin e legjislacionit. Viktimave të dhunës në familje, jo vetëm që duhet t'ju ofrohet ndihmë për një kohë të caktuar, por duhet të shqyrtohet mundësia që ato t'i kthehen familjeve apo t'iu sigurohet strehim i qëndrueshëm.

Flora Brovina – Edhe unë e përkrah këtë raport, si dhe Institucionin e Avokatit të Popullit, që e ka trajtuar këtë çështje mjaft të rëndësishme. Raporti shtron vëmendje për disa çështje shumë të rëndësishme, mirëpo i ka edhe të metat e veta. Sepse, nuk bazohet në bazë të statistikave që është dashur të shërbehet nga Enti i Statistikave dhe institucionet tjera, si në Ministrinë e Arsimit, institucionet shkollore, që të kemi një raport të bazuar në fakte dhe dëshmi. Në këtë rast, nuk

jemi në dijeni se sa përdoret metoda për planifikimin e familjes, sa kemi institucione që bëjnë planifikimin familjar, sa përdoren mjetet kontraceptive etj. Është e vërtetë se ne kemi legjislacionin e duhur, por kemi ngecje në zbatim. Në këtë rast, Ligji për abortin, kur është miratuar, ka qenë mjaft rigoroz dhe ka qenë kompakt me ligjet e BE-së. Nëse themi se ka aborte ilegale, duhet të prezantohen edhe shifra, e jo në mënyrë paushallë. Në këtë rast, nuk kemi vërejtur se është përmendur Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, i cili ka drejtoritë që merren me çështjen e shëndetit riprodhues dhe edukimin shëndetësor. Natyrisht, ne si Kuvend kemi për obligim monitorimin e zbatimit të legjislacionit. Një shqetësim, të cilin e kemi theksuar edhe gjatë shqyrtimit të Ligjit për shëndetësinë, mungesa e specialistëve pediatër të mjekësisë shkollore. Mungojnë mjekët nëpër shkolla, jo vetëm për edukimin e shëndetit riprodhues, por edhe të edukimit seksual të fëmijëve. Por, edhe për arsye të shfaqjes së dukurive tjera negative nëpër shkolla, në mesin e tyre përdorimin e substancave narkotike. Falënderojmë Avokatin e Popullit, që na ka sjellë në vëmendje këtë çështje, e cila është mjaft e rëndësishme.

Enver Hoti – Raporti i Avokatit të Popullit, lidhur me të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues, është një temë mjaft e rëndësishme. Ky raport ka pasqyruar situatën reale dhe pajtohem edhe unë se këtij raporti i mungojnë statistikat. Këto rekomandime do të jenë një bazë e mirë për ne, që në të ardhmen, t'i adresojmë si institucione. Rekomandimi për Kuvendin e Kosovës, në këtë rast, ka rekomanduar që të ndryshohet Kushtetuta dhe të përfshihet marrëveshja ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Konventën e personave me aftësi kufizuar dhe Kartën sociale të Evropës, në mënyrë që të jenë direkt të aplikueshme në legjislacionin vendor. Pra, ne si institucione duhet t'i përgjigjemi Institucionit të Avokatit të Popullit, për çdo rekomandim, se a është adresuar apo kur do të adresohet. Si komision, rekomandimet që kanë të bëjnë me fushëveprimin tonë, duhet t'i trajtojmë këto rekomandime, dhe nëse ka nevojë, edhe ndryshime në ligje të caktuara. Është dokument i rëndësishëm dhe është e vërtetë se ka mungesë të dhënave të sakta, megjithatë duhet trajtuar këto shqetësime.

Haxhi Avdyli – Këtij raporti i mungojnë statistikat, siç e potencuan deputetët tjerë. Pra, është raport i bazuar në opinion, jo në bazë të evidencave. Në Kosovë, kemi shumë mungesë të statistikave, sidomos në sektorin e shëndetësisë, në mënyrë që të kemi një pasqyrim real të problemit. Është raport pozitiv, pra një përmbledhje e të gjitha shqetësimeve të aktorëve lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues. Në këtë raport nuk e kam hasur mjekësinë primare, që luan rol shumë të madh në këtë drejtim. Është kontakti i parë që ka të bëjë me pacientët. Dhe në këtë rast, duhet të bëjmë më shumë në fuqizimin e mjekësisë primare. Pra, si institucione, aty ku ka përparim, sa i përket këtyre rekomandimeve, të evidentohen aty ku vlerësohet se kemi ngecje, duhet adresuar rekomandimet, për të përmirësuar situatën.

Kryetarja, pas diskutimeve që u zhvilluan lidhur me raportin, komisioni nxori këto:

P ë r f u n d i m e

1. Raporti është gjithëpërfshirës dhe mbulon një fushë të gjerë të problemeve të shëndetit seksual dhe riprodhues në Kosovë.
2. Rekomandimet duhet të adresohen dhe të zbatohen nga institucionet përkatëse.
3. Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, edhe më herët, ka diskutuar dhe ka adresuar disa nga rekomandimet e përfshira në raport.
4. Komisioni është tani në procedim të Rezolutës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

5. Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale do t'i adresojë të gjitha rekomandimet që bien në fushëveprimin e komisionit dhe do të kërkojë raportim në komision nga ministrat e linjave, lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve.
6. Me gjithë aspektin gjithëpërfshirës të raportit, komisioni konkludon që raporti duhet të përmbajë edhe të dhëna statistikore nga institucionet relevante lidhur me të gjeturat e cekura në rekomandime.

3. Diskutim i Draft-Rezolutës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Kryetarja – Kjo pikë ka të bëjë edhe me rekomandimet e Avokatit të Popullit, që i diskutuam, i cili ka kërkuar që të adresohen Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Në këtë rast, pra njëri nga rekomandimet, po konsiderojmë se po përmbushet. Si komision, kemi takuar edhe drejtorin e UNDP-së, ku kemi diskutuar për draft-rezolutën dhe mbështetjen e tyre, sa i përket rezolutës, si dhe çështjeve tjera të rëndësishme, në këtë rast, edhe mbështetjen për Projektligjin për ndërmarrjet sociale, i cili në një mënyrë, adreson shumë çështje që kanë të bëjnë me OZHQ. Ne e kemi shqyrtuar këtë rezolutë dhe sot, para nesh, kemi draft-rezolutën, të cilën nëse jeni të pajtimit, pas shqyrtimit të këtij drafti, ta procedojmë për në seancë për votim.

Nora Sahatçiu (UNDP) – Falënderoj komisionin për përkrahjen lidhur me procedimin për miratim të Rezolutës për OZHQ-në apo agjenda 2013. Siç e theksuat, ne si UNDP, edhe përmes drejtorit tonë, z. Russell iu kemi ofruar mbështetje, si për rezolutën, ashtu edhe për çështjet tjera me rëndësi. Ky është vetëm draft dhe ju si komision mund ta plotësoni, nëse vlerësoni se mund të plotësohet, që pas miratimit, të jetë sa më lehtë e zbatueshme. Po ashtu, është shumë pozitive që komisioni dhe Kuvendi, njëkohësisht e ka vlerësuar agjendën 2013, si diçka shumë pozitive për Kosovën. Në pamundësi, për shkak të statusit të Kosovës, për të nënshkruar rezolutën më të gjitha shtetet anëtare, në shtator të vitit 2015, megjithatë ka treguar seriozitet dhe përkushtim që një agjendë e tillë, që i përfshin të gjitha sferat zhvillimore edhe politike të Kosovës, është me rëndësi që në këtë rast të formalizohet prej institucioneve të Kosovës, përmes miratimit të kësaj rezolute dhe në baza të rregullta të raportohet mbi progresin e përmbushjes së këtyre objektivave. Ne, edhe njëherë, konfirmojmë mbështetjen e UNDP-së për agjendën 2030, si dhe çështje tjera që konsideroni se mund t'ju ndihmojmë, në këtë rast, edhe në aspektin e shkëmbimit të përvojave, se çka kanë bërë shtetet tjera në adresimin apo përmbushjen e agjendës 2030.

Kryetarja, pas diskutimeve, komisioni miratoi Rezolutën e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm - agjenda 2030 për Kosovën dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Rezoluta e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm -agjenda 2030 për Kosovën.

3. Të ndryshme

Kryetarja– Këtë javë propozojmë që të realizojmë vizitën në SHSKUK.

Komisioni vendosi që të mërkurën, më datë 20.12.2017, të realizojë vizitën në SHSKUK, të takojë drejtorin e SHSKUK- së, si dhe të vizitojë Klinikën e Reumatologjisë dhe Neurokirurgjisë.

Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përqatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU